

Në bazë të nenit 7 të Ligjit për kulturë (“Gazeta zyrtare e RM-së nr. 31/98, 49/03, 82/05, 24/07, 116/10, 47/11, 51/11, 136/12, 23/13, 187/13, 44/14, 61/15, 154/15 dhe 39/16) dhe nenit 10, 22 dhe 41 të Ligjit për Qytetin e Shkupit (“Gazeta zyrtare e RM-së nr. 55/04),

QYTETI I SHKUPIT

shpall

THIRRJE PUBLIKE

për ndarjen e mjeteve për financimin e programeve dhe projekteve nga fusha e kulturës me interes për Qytetin e Shkupit për vitin 2018

I

Për realizimin e nevojave publike nga fusha e kulturës, Qyteti i Shkupit shpall Thirrje publike për ndarjen e mjeteve për financimin e programeve dhe projekteve nga fusha e kulturës me interes për Qytetin e Shkupit për vitin 2018.

Veprimtaritë kulturore, programet, manifestimet dhe mjetet financiare për realizimin e tyre përcaktohen me programin vjetor për kulturë të Qytetit të Shkupit për vitin 2018.

II

Në Thirrje publike mund të marrin pjesë artistë, artistë të pavarur, institucione lokale, institucione nga fusha e kulturës, shoqata civile, fondacione dhe persona të tjerë juridikë dhe fizikë që kryejnë veprimtari nga fusha e kulturës në përputhje me Ligjin për kulturë dhe dispozitat e tjera ligjore në Republikën e Maqedonisë.

III

Qyteti i Shkupit do të marrë pjesë në financimin e programeve, projekteve dhe aktiviteteve në përputhje me dispozitat ligjore, mbi bazën e “Qëllimeve dhe kriterëve për zgjedhjen e projekteve nga fusha e kulturës me interes për Qytetin e Shkupit”, si vijon:

1. Përkrahja e projekteve, manifestimeve dhe aktiviteteve nga fusha e veprimit profesional, amator dhe rinor, në fushat vijuese:
 - 1.1. Arte teatrale
 - 1.2. Arte muzikore
 - 1.3. Arte vizuale dhe arte të medimeve të reja
 - 1.4. Veprimtari botuese dhe bibliotekare
 - 1.5. Veprimtari muzeore dhe promovimi i trashëgimisë kulturore
2. Bashkëpunim ndërkombëtar.
3. Profesionale, amatore dhe rinore si nënkategori për çdo fushë.

IV

Përveç fushave specifike të përmendura, fletëparaqitjet e deponuara duhet të plotësojnë “Qëllimet dhe kriteret për zgjedhjen e projekteve nga fusha e kulturës me interes për Qytetin e Shkupit” që janë dhënë të bashkëngjitura me Thirrjen publike të shpallur në Ueb portalin zyrtar të Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk.

V

Paraqitja për Thirrjen publike realizohet me deponimin e fletëparaqitjes së plotësuar (aplikacioni).

Aplikuesit, përveç fletëparaqitjes, detyrimisht duhet të deponojnë edhe këto dokumente vijuese:

- dokument për veprimtari të regjistruar të lëshuar nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë,
- vërtetim për xhiro llogari të hapur dhe aktive.

Aplikuesit, të bashkëngjitur me fletëparaqitjen, duhet të deponojnë edhe dokumente të tjera, të lidhura me realizimin e aktivitetit (kontrata autoriale me pjesëmarrësit, ambient të siguruar ose partneritet me ndonjë institucion/organizatë, ftesë për pjesëmarrje në festival në shtete të huaja, mjete financiare të siguruara në mënyrë plotësuese etj.)

Fletëparaqitjet (aplikacionet) mund të merren në Sektorin për veprimtari publike – Seksioni për kulturë i Qytetit të Shkupit (baraka 2) Arkivi i Qytetit të Shkupit ose nga Ueb portali zyrtar i Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk

VI

Thirrja publike zgjat deri më 18.12.2017 nga dita e shpalljes në mjetet për informim publik dhe portalin zyrtar të Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk.

Fletëparaqitjet, në formë të shkruar dhe të incizuara në CD në format WORD, duhet të deponohen pranë Qytetit të Shkupit, nëpërmjet postës në adresën: Bul. "Ilinden" nr. 82, 1000 Shkup, ose në Arkivin e Qytetit të Shkupit, më së voni deri në orën 18:00 në ditën e fundit të përfundimit të afatit të Thirrjes publike (18.12.2017), me shënimin "**Thirrje publike për ndarjen e mjeteve për financimin e programeve dhe projekteve nga fusha e kulturës me interes për Qytetin e Shkupit për vitin 2018**".

Vërejtje: Fletëparaqitjet me të dhëna të paplota dhe dokumentacioni jo i plotë, fletëparaqitjet e plotësuara me formularë jo adekuatë, si dhe ato që nuk do të deponohen në afatin e caktuar, nuk do të shqyrtohen.

Rezultatet e Thirrjes publike do të shpallen në "Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit" dhe në ueb portalin zyrtar të Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk, me shpalljen e Programit për financimin e programeve dhe projekteve nga fusha e kulturës me interes për Qytetin e Shkupit për vitin 2018.

Informacione plotësuese mund të merren në telefonin 02/ 3297-323, 02/ 3297 – 324, 02/ 3297 – 289.

KRYETARI I QYTETI I SHKUPIT

Petre Shilegov